



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9.5.2023

Nr: 467

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHKARKIMIN E SEKRETARIT TË KZAZ NR.82, BASHKIA DROPULL, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenet 10 dhe 12 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është depozituar procesverbali i mbajtur nga KZAZ nr. 82, Bashkia Dropull, në të cilën referohet si më poshtë:

“KZAZ nr. 82, Bashkia Dropull, raporton mungesën në mënyrë të vazhdueshme të sekretarit të propozuar nga Partia e Lirisë (si e drejtë e kaluar nga krijimi i vakancës së PD). Në vijim të punës së KZAZ, mungesa e sekretarit përbën shqetësim në mbarëvajtjen e procesit dhe ecurinë e punës”.

KZAZ nr. 82, Bashkia Dropull, ka depozituar në KQZ dorëheqjen e sekretarit duke referuar se, sekretari e ka konsideruar të mirëqënë dorëheqjen dhe nuk është paraqitur më në detyrë që nga data 02.05.2023, datë në të cilën ka dhënë edhe dorëheqjen.

Vendimi nr. 5, datë 20.11.2020, i Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, në nenin 12, pikat 1 dhe 4 përcakton se anëtari apo sekretari i KZAZ-së i shkarkuar, i liruar apo dorëhequr nga detyra, nuk mund të largohet nga KZAZ-ja, pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij. Komisioneri njofton subjektin përkatës të dorëzojë në KQZ, brenda tre ditëve gjatë periudhës zgjedhore dhe brenda tre orëve në ditën e zgjedhjeve, propozimin dhe dokumentacionin për vendin vakant të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.

Data: 9.5.2023 Nr: 467
Ora: 11:00



“Për shkarkimin e sekretarit të KZAZ nr.82, Bashkia Dropull, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”

Referuar nenit 10, shkronja “c” të këtij vendimi, Komisioneri shkarkon nga detyra anëtarin dhe sekretarin e KZAZ-së kur mungon pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tre mbledhje rresht të KZAZ-së.

Për sa më sipër, sekretari i KZAZ edhe kur jep dorëheqjen duhet të qëndrojë në detyrë deri në zëvendësimin e tij, si dhe të mos mungojë në më shumë se tre mbledhje rresht të KZAZ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenin 10 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”,

V E N D O S:

1. Shkarkimin nga detyra të sekretarit të KZAZ-së nr. 82, z. Dhimitër Koco Harito, Bashkia Dropull, të propozuar nga Partia e Lirisë.
2. Partia e Lirisë duhet të dorëzojë propozimin për plotësim të vakancës brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI